

AKT - THEMELIMI
i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar



"SH P K APOLLO"

Sot me date 26/2/1999, ne Tirane une : **Z. Sokol Meqemea** , i datelindjes 28.06.1969 vendlindja Tirane dhe banues ne Tirane vendosi me vullnetin e tij te lire dhe te plote te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar **"SH P K APOLLO"** me qender ne Tirane.

HYRJE

Ne kuptim te ketij Akti-Themelues Ortaku Sokol Meqemea eshte Themelues i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **"SH P K APOLLO"** me qender ne Tirane.

Qellimi i ketij Akti-Themelimi eshte krijimi i Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar **"SH P K APOLLO"** me qender ne Tirane dhe me shtrirje ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar **"SH P K APOLLO"** me qender ne Tirane e rregullon aktivitetin e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, Ligjin Nr. 7512 date 10/08/1991, Kodin Tregtar (Ligji Nr. 7638 date 19/11/1992) dhe akte te tjera ligjore te legjislacionit shqiptar.

OBJEKTI

Objekti i veprimtarise se Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **"SH P K APOLLO"** do te jete si me poshte vijon:

- 1.Import Export , artikuj te ndryshem.

AFATI I VEPRIMTARISE

Aktiviteti privat i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **"SH P K APOLLO"** do te zhvillohet me nje kohezgjatje 10 vjet.

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar **"SH P K APOLLO"** eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin ne Gjykaten e Rrethit te Tiranës dhe pajisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga Dega e Tatim-Taksave, Tirane.



KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali Themeltar i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SH P K APOLLO" sh.p.k., me qender ne Tirane, do te jete ne madhesine prej 100.000 leke. Ortaku i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SH P K APOLLO", Z. Sokol Meqemea, disponon kete shume ne masen prej 100%.

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "SH P K APOLLO" do te jete me adrese: rr."Kongresi i Lushnjes". P. 46 *Sh. 2 of 16.*

THEMELUESI

Sokol Meqemea



STATUTI

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "SHPK APOLLO" krijohet nga **Z.Sokol MEQEMEJA** ne baze te kritereve te percaktuara ne Ligjin Nr. 7512 dt. 10.08.1991, Ligjin Nr. 7638 dt.19.11.1992, "Per Shoqerite Tregtare" dhe Kodin Tregtar te Republikes se Shqiperise.

NENI 2

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar **"SHPK APOLLO"** e ushtron aktivitetin e saj ne baze te ekonomise se tregut te lire.

NENI 3

Ortaket e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **"SHPK APOLLO"** ne kete sipermarrje kane derdhur kapitalin e tyre vendas me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private e Shoqerise, si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne Kapitalin Themeltar.

NENI 4

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar **"SHPK APOLLO"** eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes dhe pajisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga Dega e Tatimeve te Tiranes.

EMRI; SELIA; TERRITORI

NENI 5

Emertimi i Shoqerise do te jete **"SHPK APOLLO", Tirane.**

NENI 6

Selia e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **"SHPK APOLLO"** do te jete me adrese: **Rr. "Kongresi i Lushnjes"**. P.76 Sh. 2 ep 16.



NENI 7

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "SHPK APOLLO" do te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise nepermjet filialeve te saj.

NENI 8

Aktiviteti privat i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SHPK APOLLO" do te zhvillohet me nje kohezgjatje 10 vjet.

OBJEKTI

NENI 9

Objekti i veprimtarise se Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SHPK APOLLO" eshte:

1. Import-Eksport artikuj te ndryshem.

NENI 10

Kapitali Themeltar i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SHPK APOLLO", Tirane, do te jete ne madhesine prej **100.000,00 Leke**.

NENI 11

Kapitali Themeltar mund te rritet me shtimin e aktivitetit te Shoqerise. Zvoglimi i Kapitalit Themeltar nen vleren 100.000,00 Leke e detyron Shoqerine te shnderrohet ne nje forme tjeter ne rast se ajo nuk merr nje vendim per rritjen e Kapitalit Themeltar deri ne vleren e mesiperme.

NENI 12

Me pelqimin e Ortakut Themelues pjese te Kapitalit Themeltar jane te transferueshme ne rruge trashegimie ose personave te tjere qe nuk bejne pjese ne shoqeri.

NENI 13



Ne rast te shtimit te numrit te ortakeve, pjese te Kapitalit Themeltar mund te transferohen me pelqimin tone . Transferimet e Kapitalit Themeltar do te vertetohen me Akt Noterial.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

NENI 14

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "SHPK APOLLO" me qender ne Tirane do te kete si Administrator te saj Z. Sokol MEQEMEA .

NENI 15

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e veprimtarise se Shoqerise. Ai mund te kryeje te gjitha veprimet e administrimit per interes te Shoqerise.

NENI 16

Ne marredhenie me persona te trete administratori e angazhon Shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj te veprimtarise.

NENI 17

Ortaku Themelues kane ne kompetence:

1. Te miratojne programin e Shoqerise, te kontrollojne raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore.
2. Te vendosin per shperberjen e Shoqerise.
3. Te rregullojne marredheniet e punesimit dhe te shperblimit brenda Shoqerise.
4. Sipas akteve ligjore bejne shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve shteterore, personave Juridike dhe Fizike, shtetasve shqiptare apo te huaj qofshin.

Neni 18

Administratori ka te drejte te informohet per veprimtarine e shoqerise si dhe te njihet me te gjitha dokumentet e saj dhe llogarite perkatese ne rast se keto mbahen nga persona te tjere te caktuar prej tij.

NENI 19

Administratori e humbet detyren e tij ne rast te prishjes se Shoqerise ose transformimit te saj ne nje lloj tjeter shoqerie te parashikuar ne legjislacionin shqiptar.



KREU II

MARREDHENIET FINANCIARE

NENI 20

Shoqeria me Përgjegjësi të Kufizuar "SHPK APOLLO" me qendër në Tiranë mund të lidhë kontrata me sektore shtetërore, drejtperdrejt në tregun e lirë, si dhe me persona Juridike e Fizike, vendas apo të huaj qofshin.

NENI 21

Në veprimet kontraktuale, Shoqeria përfaqësohet nga Administratori i saj ose nga persona të tjerë të caktuar prej tij.

NENI 22

Shoqeria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, sigurimet shoqërore, etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likuiduese pranë bankave të vendit si dhe të kryejë veprimet likuiduese nëpërmjet tyre.

NENI 23

Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike Shoqeria ka të drejtë të vetfinansohet në monedhë vendase ose në valute të huaja. Shkëmbimin e monedhës vendase në valute të huaja dhe anasjelltas, Shoqeria mund ta kryejë në përputhje me kursin e këmbimit të caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose nëpërmjet kursit të paraqitur nga agjensite valutore.

NENI 24

Për pasqyrimin e aktivitetit privat, Administratori ose persona të tjerë të caktuar prej tij, janë të detyruar të mbajnë dokumentacion të rregullt financiar si dhe regjistrat përkatës sipas ligjit të vecantë.

NENI 25

Veprimtaria ekonomike e Shoqërisë mbaron në muajin Dhjetor të çdo viti. Administratori ose personat e tjerë të caktuar prej tij janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor si dhe deklaratën e të ardhurave dhe t'i depozitojnë ato në organin financiar të juridiksionit përkatës.

KREU III



MARREDHENIT E PUNESIMIT

NENI 26

Ortaku themelues vendosin per shtimin ose pakesimin e numrit te ortakeve si dhe personave te tjere te cilet jane te punesuar ne veprimtarine e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SHPK APOLLO", Tirane.

NENI 27

Marredhenit e punesimit brenda Shoqerise rregullohen sipas kontrates se punes (individuale) qe lidhet ndermjet paleve, ne perputhje me Kodin e Punes dhe Legjislacionin Shqiptar.

NENI 28

Marrja ne pune behet me rregjistrimin nga Punedhenesi ne Librin e Punes se Shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e Punes se Juridiksionit ku Shoqeria ushtron aktivitetin e saj.

NENI 29

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet mbi baze te nje akti me shkrim te leshuar nga Ortaku Themelues. Largimi lidhet me mbarimin e Kontrates se Punes per shkak te shkeljeve te disiplinore, me kerkesen e vete te interesuarit, me marrjen fund te personit juridik, ne rast te forces madhore.

NENI 30

Largimi nga Shoqeria behet mbasi jane shlyer te gjitha detyrimet materiale dhe monetare.

ELEMENTE TE TJERE

NENI 31

Shoqeria mund te bleje truall per ndertim ose ta marre ate me qera, si dhe objekte te ndryshme ne pronesi sipas nje kontrate te vecante. Dhenia dhe vlefta perkatese e tyre percaktohen nga organi financiar ne juridiksionin e te cilit ndodhet trualli ose objekti.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 32

Pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, detyrimeve te tjera ndaj shtetit, sigurimeve shoqerore, etj., te ardhurat kalojne ne pronesi te ortakeve.

PERGJEGJESITE LIGJORE

NENI 33

Ortaku Themelues jane pergjegjes individualisht, sipas rastit, ndaj Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SHPK APOLLO" ose te treteve, per shkelje te Statutit, apo per faje te tjera te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

NENI 34

Persa nuk eshte shprehur ne Statut, gjithshka i referohet Ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" ne vecanti dhe Legjislacionit Shqiptar ne pergjithesi.

NENI 35

Statuti i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SHPK APOLLO", eshte hartuar me vullnet te lire dhe te plote te Z. Sokol MEQEMEA dhe eshte firmosur e vulosur prej tyre .

ORTAKU THEMELUES

Tirane, me 26.02 1999

Sokol MEQEME

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 450 Rep
Nr. 83 Kol

VERTETIM

Sot me date 26.02 /1999, para meje noteres Marijeta Brindku paraqit personalisht z Sokol Meqemea, i datelindjes 28.06.1969 me kombesi dhe shtetesi shqiptare, lindur dhe banues ne Tirane i regjistruar me Nr. pasaporte 0043910, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se aktin e themelimit dhe statutin e mesiperme e ka redaktuar vete, me vullnetin e tij te lire dhe te plote, kurse une noterja duke qene e rregullt sipas ligjit e firmosa ate.



NOTERE
Marijeta Brindku
REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE